



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Tel: 033 421214; Fax 033 421201; www.vlora.gov.al; E-mail: info@vlora.gov.al

RELACION TEKNIK

PROJEKT: Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga rrugët "Bulevardi Cameria", rruga "Pelivan Leskaj", Bulevardi "Pavarësia", rruga "Kujtim Beqiri-Pirro Sava" (**VAZHDIM PUNIMESH FAZA E 2-te**)

RELACION TEKNIK

Relacioni ne vijim i përket ndërhyrjes per vazhdimin per ne fazen e dyte se Rikualifikimit te bllokut te banesave kufizuar nga bulevardi Cameria, rruga Pelivan Leskaj, Bulevardi Pavaresia dhe rruga Kujtim Beqiri, rruga Pirro Sava.

Behet fjale per nje nga blloqet e banimit me te rinj (te ndërtuar ne pesembedhjetë vjecarin e fundit) te shtrire ne qendër te qytetit te Vlorës. Blloku ka ka një densitet te larte banimi – i përbërë kryesisht nga banesa mbi 10 kate por dhe nga shtepi perdhese.

Projekti ne fazen e pare te tij ka mundur te mbylle nje pjese te konsiderueshme te aksit rrugor , por ne mungese te fondeve ne kete bllok banimi , kerkohet qe te plotesohen me nderhyrje dhe dy akse rrugor ku zgjidhin dhe kornizojne perfundimisht ne rehabilitim te plote kete bllok .



Ne kete faze behet fjale per bashkimin e rrugeve Naim Frasheri , i cili bashkohet ne anen lindore te objektit 8 kt , ku bashkohet me rrugen Ali Asllani qe ndodhen brenda ne bllok dhe perfundon me rrugen Jani Kosta dhe daljen ne shetitoren Lungo Mare. Ky eshte Aksi A –A kryesor i cili ka nje gjatesi 231.15 ml .

Kemi te parashikuar per nderhyrje dhe Aksin ne B-B, e cila eshte seksioni , ne anen perendimore te ketij objekti 8 kt me gjatesi 75 ml ,ku fillon me bashkimin e Rruges

PROJEKT: Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga rrugët "Bulevardi Cameria", rruga "Pelivan Leskaj", Bulevardi "Pavarësia", rruga "Kujtim Beqiri-Pirro Sava" (**VAZHDIM PUNIMESH FAZA E 2-te**)

Naim Frasheri dhe lidhet me aksin kryesor A –A , dhe rrugen Ali Asllani dhe perfundon ne Lungo Mare

Ne pamjen e mëposhtme paraqitet pozicioni i sipërfaqes ne qytetin e Vlorës.




PROJEKT: Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga rrugët "Bulevardi Cameria", rruga "Pelivan Leskaj", Bulevardi "Pavarësia", rruga "Kujtim Beqiri-Pirro Sava" (**VAZHDIM PUNIMESH FAZA E 2-te**)

Gjendja aktuale

Kjo zone e qytetit ka pasur një zhvillim të vrullshëm në pesëmbëdhjetë vjeçarët e fundit por urbanizimi dhe sistemimi i hapësirave nuk ka ndjekur hapin e ndërtimit. Aktualisht në fazën e parë të projektit janë realizuar ndërhyrja në rrugicat në brendësi të bllokut të banimit, me të gjitha shtresat asfaltike me trotuare dhe ndricim rrugor. Por brenda këtij blloku, kanë paraqitur edhe seksione të tjera të rrugëve të cilat nuk bëjnë pjesë në rehabilitimin në fazën e parë të realizuar dhe të përmbyllur, ku është e domosdoshme ndërhyrja e menjëhershme e tyre, në mënyrë që të përmbyllet sistemi i rehabilitimit urban në këtë bllok.

Në këtë fazë do të realizohet lidhja e rrugës Naim Frashëri, i cili bashkohet në anën lindore të objektit 8 kt, ku bashkohet me rrugën Ali Asllani që ndodhet brenda në bllok dhe përfundon me rrugën Jani Kosta dhe dalje në shetëtorën Lungo Mare mungon një sistem i mirëfilltë kullimi urban.

Në pamjet e mëposhtme mund të vërehet qartë gjendja e rëndë e infrastrukturës dhe e hapësirave publike.



PROJEKT: Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga rrugët "Bulevardi Cameria", rruga "Pelivan Leskaj", Bulevardi "Pavarësia", rruga "Kujtim Beqiri-Pirro Sava" (**VAZHDIM PUNIMESH FAZA E 2-te**)

Projekti


Projekti synon kthimin e zonës me standarde bashkëkohore dhe krijimin e një modeli për te ndjekur ne te gjitha ndërhyrjet pasardhëse ne blloqet e tjera te qytetit.

Projekti parashikon piketimin dhe plotësimin dhe ndërtimin e rrugëve të rrugëve të pa plotësuara në ndërtim në fazën e parë , dhe vazhdimin e tyre në këtë fazë të dytë, shërbim te banoreve.


Rrugët do te kenë një gjerësi mesatare nga 5 – 6 m (ne varësi te funksionit), do te jene te ndriçuara dhe te pemezuara ne te dy anët. Parashikohet ndërtimi i trotuareve përgjatë rrugëve me një gjerësi mesatare prej 1.0 - 2.0 m (në varësi të hapësirës) dhe sheshe te përbashkëta.

Rrugët do te kene kuneta anesore ne te dy anet e saj me gjerësi 50cm rruga kryesore do te kete nje gjerësi 6 m , kurse rruget e tjera do te jene rruge ndihmese me gjerësi ne varesi te funksionit .

Përgjatë gjithë rrugëve është parashikuar sistemi i kanalizimit KUB (ujerave te bardha) nepermjet tubacioneve me diameter Ø 400. Zgarat e shiut do te vendosen përgjate kunetave dhe do te lidhen me tubacionet nepermjet tubove me diameter Ø 200.



Me poshte nje planimetri e njerit prej segmenteve te rruges.



Ndriçimi do te realizohet me shtylla metalike me lartesi 7m te vendosura ne te dy anet e rruges. Shtyllat do te jene me krah nje degesh.

Shtresat qe do te perdoren per ndertimin e rruges do te jene si me poshte:

- Shtrese cakelli 20 cm perhapur dhe ngjeshur me makineri
- Shtrese cakelli 20 cm perhapur dhe ngjeshur me makineri
- Shtrese stabilizanti 10 cm perhapur dhe ngjeshur me makineri
- Shtrese binderi 4 cm perhapur dhe ngjeshur me makineri
- Shtrese asfalti 4 cm perhapur dhe ngjeshur me makineri

Shtresat qe do te perdoren per ndertimin e trotuareve do te jene si me poshte:

- Shtrese zhavori lumi $t=20\text{cm}$, perhapur e ngjeshur me makineri
- Trotuar me pllaka betoni $t=6\text{cm}$, mbi nenshtrese granili $t=10\text{cm}$.

Grupi i Projektimit:

Ing. Erjon Amataj

Ark. Rubin Hekurani

Top. Kismet Agalliu

Ing. Darjan Hudhra

PROJEKT: Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga rrugët "Bulevardi Cameria", rruga "Pelivan Leskaj", Bulevardi "Pavarësia", rruga "Kujtim Beqiri-Pirro Sava" (**VAZHDIM PUNIMESH FAZA E 2-te**)